

**William R. Hite, Jr., Ed.D.**

Superintendent

6 Gusht, 2020

Të Dashur Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Unë po shkruaj për të dhënë një informacion të ri mbi përpjekjet për përmirësimin e ndërtesave të shkollave..

Që nga mbyllja e ndërtesave tona shkollore në Mars 2020 për shkak të pandemisë COVID-19, Drejtoria ka përshpejtuar përpjekjet e saj të përmirësimit të ndërtesave shkollore. Ne kemi investuar afër 264 milion dollarë për përmirësime në 61 shkolla duke përfshirë:

- 61 projekte kapitale si zëvendësime të çatisë, zëvendësime / riparime të bojlerit, përmirësime të sistemit HVAC dhe sistemit elektrik dhe rinovime të banjove
- 147 modernizime në klasa në 11 shkolla që mbështesin përpjekjet e edukimit të hershëm
- 24 lysterje dhe projekte suva, duke e çuar numrin tonë të përgjithshëm të shkollave të "Certified Lead Safe " në 110
- ventilime dhe riparime të dritareve
- heqjen e mbi 250,000 (feet) të asbestit që përmbajnë materiale të tilla si pllaka dysHEMEJE dhe izolim tubash

Informacione më të hollësishme për secilin projekt janë në dispozicion në faqen e internetit në Capital Programs [këtu](#). Faqja do të azhurnohet shpesh pasi përfundojnë projektet dhe janë planifikuar projekte të reja.

Ne e dimë se ka shumë më tepër për të bërë. Fillimi i vitit të ri shkollor me të gjithë studentët e angazhuar në mësimin dixhital përmes periudhës së parë (deri më 17 Nëntor) na lejon të zgjerojmë më tej përpjekjet tona për zvogëlimin e asbestit dhe riparimin në 28 shkolla. Këto projekte u zgjodhën sepse ato mund të përfundojnë deri më 17 Tetor, duke lejuar që ndërtesat të pastrohen dhe të përdoren për të mësuar personalisht brenda 17 Nëntorit, nëse është e nevojshme.

Ne mbetemi të përkushtuar për punën tonë të vazhdueshme për të pasur ndërtesa të sigurta dhe një ambient mikpritës të shkollës gjë që meritojnë studentët dhe personeli ynë. Në rast se mësimi dixhital vazhdon përtej periudhës së parë, ne do të vazhdojmë të përshpejtojmë përpjekjet tona për përmirësim siç lejojnë fondet. Si kujtesë, zëri juaj ka rëndësi kur bëhet fjalë për mbrojtjen e fondeve që aq shumë i duhen Drejtorisë sonë. Ju mund të vizitoni [philasd.org/fundourschools](https://philasd.org/fundourschools) për të gjetur burime dhe të mësoni më shumë rreth asaj se si mund të ndihmoni.

Faleminderit për partneritetin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme ndërsa punojmë së bashku për t'u përgatitur për një vit shkollor të sigurt dhe të suksesshëm!

Sinqerisht,

A handwritten signature in cursive script that reads "William R. Hite Jr." followed by a flourish.

William R. Hite Jr., Ed.D.  
Superintendent  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias